

Formular për SYLLABUS të Lëndës

Të dhëna bazike të lëndës	
Njësia akademike:	Fakulteti Juridik
Titulli i lëndës:	Procese Gjyqësore Kushtetuese (me vendim të Këshillit të Fakultetit tani “Mbrojtja Kushtetuese e Lirive dhe të Drejtave Themelore”.
Niveli:	Master
Statusi lëndës:	Obligative
Viti i studimeve:	III
Numri i orëve në javë:	2
Vlera në kredi – ECTS:	5
Koha / lokacioni:	Prishtinë
Mësimdhënësi i lëndës:	Prof. Dr. Asoc. Visar Morina
Detajet kontaktuese:	visar.morina@uni-pr.edu
Përshkrimi i lëndës	<p><i>Studentët do të fitojnë shkathtësi praktike juridike dhe kushtetuese të referimit të kërkesave individuale pranë Gjykatës Kushtetuese të Kosovës, dhe atë si nga aspekti procedural ashtu edhe në aspekt përmbajtësor. Në kuadër të kësaj lënde të specializuar një theks i veçantë do ti kushtohet mbrojtjes kushtetuese të lirive dhe të drejtave themelore në Kosovë, procedurës e cila zhvillohet para Gjykatës Kushtetuese, argumentimit kushtetues dhe zbatimit direkt të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut dhe të familjarizimit të studentëve me jurisprudencën e Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut në referimin e kërkesave individuale kushtetuese, veçanërisht të parimit të proporcionalitetit dhe të konceptit të detyrimeve pozitive.</i></p> <p><i>Vëmendje e veçantë gjatë kësaj lënde do ti kushtohet ankesës individuale dhe elementeve të saj, e cila siç vërehet edhe nga jurisprudenca e Gjykatës Kushtetuese të Kosovës plotëson rreth 90 % të praktikës gjyqësore.</i></p>
Qëllimet e lëndës:	<ul style="list-style-type: none"> ▪ Fitimi i njohurive teorike dhe praktike për

	<p><i>procedurën e mbrojtjes së lirive dhe të drejtave kushtetuese në Kosovë;</i></p> <ul style="list-style-type: none"> ▪ <i>Aftësimi dhe pajisja me njohuri të studentëve lidhur me qëndrimin e kushtetutave për kufizimin e lirive dhe të drejtave kushtetuese, për kufijtë kushtetues të këtyre kufizimeve të vendosur nga Gjykata Kushtetuese e Kosovës dhe në harmoni me Gjykatën Evropiane për të Drejtat e Njeriut.</i> ▪ <i>Përvetësimi i njohurive praktike të argumentimit kushtetues në procedurën e referimit kushtetues konform nenit 113 të Kushtetutës së Kosovës (individual <u>constitutional complaint procedure</u>).</i>
--	---

<p>Rezultatet e pritura të nxënies:</p>	<ul style="list-style-type: none"> ▪ <i>Pas mbarimit të kursit studentët do të arrijnë të njohin në mënyrë të detajzuar kriteret formale për referimin e kërkesave individuale para Gjykatës Kushtetuese;</i> ▪ <i>Studentët do të arrijnë që të ndërtojnë argumentet kushtetuese në saktësimin e kërkesës kushtetuese dhe do të arrijnë që të mbështesin pretendimet kushtetuese dhe me praktikën relevante të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut e cila në kuptim të nenit 53 të Kushtetutës së Kosovës është direkt e zbatuar në Kosovë.</i>
--	--

Kontributi në ngarkesën e studentit (gjë që duhet të korrespondoj me rezultatet e të nxëniet të studentit)

Aktiviteti	Orë	Ditë/javë	Gjithësej
Ligjërata	2	14 javë	28 orë
Ushtrime teorike/laboratorike	2	14 javë	28 orë
Punë praktike	1	14 javë	14 orë
Kontaktet me mësimdhënësin/konsultimet	5	-	5 orë
Ushtrime në teren			
Kollokfiume,seminare	4	-	4 orë

Detyra të shtëpisë	5	-	5 orë
Koha e studimit vetanak të studentit (në bibliotekë ose në shtëpi)	3	14 javë	42 orë
Përgatitja përfundimtare për provim	3	1 javë	3 orë
Koha e kaluar në vlerësim (teste,kuiz,provim final)	3	1 javë	3 orë
Projektet,prezentimet ,etj	1	5 javë	5 orë
Totali			137 orë

Metodologjia e mësimdhënies:	<p><i>Përshkruani se çfarë metodologjie do të përdoret gjatë ligjërimit të lëndës?</i></p> <p>Kjo lëndë do të realizohet përmes ligjërimit interaktiv por me një shkallë më të lartë të pjesëmarrjes së studentëve në raste studimore dhe hipotetike. Rastet studimore dhe hipotetike do të ju ofrohen studentëve paraprakisht së bashku me udhëzimet dhe lënda do të ketë një karakter shumë praktikë. Studentët do të ndahen në grupe për të diskutuar çështjet procedurale dhe meritat e rasteve të trajtuara.</p> <p>Për këtë do të ofrohen edhe raste të vendosura nga gjykata kushtetuese në rajon dhe Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut për të analizuar se si janë vendosur çështjet që kanë prekur liritë dhe të drejtat kushtetuese.</p> <p>Ligjëratat do ofrohen me prezantime vizuale dhe paraqitje dokumentare.</p> <p>Puna ekipore dhe praktike përmes rasteve kushtetuese do të stimulohet duke gjetur aplikueshmëri konsistente.</p>
Metodat e vlerësimit:	Vlerësimi i njohurive të studentëve bëhet gjatë

	<p>tërë semestrit, duke përfshirë pjesëmarrjen dhe aktivitetin e tyre gjatë ligjëratave, ushtrimeve, si dhe gjatë prezantimeve dhe diskutimeve në klasë.</p> <p>Vlerësimi do të bëhet në bazë të dy kollokfiumeve dhe matjes së performancës së studentit gjatë tërë semestrit.</p> <p>Pjesëmarrja dhe aktiviteti: 20% Kollokfiumet: 80%</p>
Literatura	
Literatura bazë:	<p><i>Listoni literaturën e domosdoshme.</i></p> <ul style="list-style-type: none"> ▪ <i>Visar Morina. Gjyqësia Kushtetuese. Prishtinë, 2013.</i> ▪ <i>Gjyljeta Mushkolaj,, Visar Morina, dhe Johan van Lamoen. Komentar, "Ligji për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës." (2014).</i> ▪ <i>Harris, O Boyle, Warbrick, Law of the European Convention on Human Rights, Oxford, 2014.</i>
Literatura shtesë:	<p><i>Listoni literaturën e rekomanduar/shtesë.</i></p> <ul style="list-style-type: none"> ▪ <i>Kommers, Donald P., and Russell A. Miller. The Constitutional Jurisprudence of the Federal Republic of Germany: Revised and Expanded. Duke University Press, 2012.</i> ▪ <i>Patrono, Mario. "Protection of Fundamental Rights by Constitutional Courts-A Comparative Perspective, The." Victoria U. Wellington L. Rev. 31 (2000): 401.</i> ▪ <i>Hajiyev, K. "The role of the constitutional court and ordinary courts in the protection of human rights." CDL-JU (2002) 43 (2002).</i> <p><i>Kushtetuta dhe ligje</i></p> <ul style="list-style-type: none"> ▪ <i>Kushtetuta e Republikës së Kosovës me amendamente kushtetuese</i> ▪ <i>Konventa Evropiane për të Drejtat dhe Liritë Themelore</i> ▪ <i>Ligji për Gjykatën Kushtetuese të Kosovës</i> ▪ <i>Rregullorja e Punës së GJK të Kosovës</i>

Plani i dizajnuar i mësimi:	
Java	Ligjërata që do të zhvillohet
Java e parë:	Hyrje: Kushtetutat dhe të drejtat themelore
Java e dytë:	Liritë dhe të drejtat fundamentale: korniza aktuale kushtetuese dhe juridike në Kosovë
Java e tretë:	Mekanizmat institucional për mbrojtjen e lirive dhe të drejtave themelore në Kosovë <ul style="list-style-type: none"> - Gjykatat - Avokati i Popullit - Gjykata Kushtetuese e Kosovës
Java e katërt:	Kërkesa individuale kushtetuese (neni 113 i Kushtetutës së Kosovës) <ul style="list-style-type: none"> - Fushëveprimi dhe natyra subsidiare e kërkesës - Cënimi nga autoriteti publik - Afatet kohore - Të drejtat e përshtatshme për mbrojtje nga procedura e ankesës kushtetuese - Rast Studimi
Java e pestë:	Kriteret për referim <ul style="list-style-type: none"> - Ratione Materiae - Ratione Personae - Ratione Temporis - Rast Studimi
Java e gjashtë:	Shterimi (ezaurimi) i mjeteve juridike <ul style="list-style-type: none"> - Baza kushtetuese dhe ligjore - Praktika e Gjykatës Kushtetuese të Kosovës - Praktika e Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut - Rast Studimi
Java e shtatë:	Kollokfiumi 1 (Vlerësimi i Parë)

Java e tetë:	<p>Zbatimi i Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut në procedurën e kërkesës individuale kushtetuese (neni 53 i Kushtetutës së Kosovës)</p> <ul style="list-style-type: none"> - Mbi KEDNJ dhe protokollet e saj - Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut - Pozita e Konventës në hierarkinë e akteve normative në Kosovë - Rast studimi
Java e nëntë:	<p>Kufizimi i lirive dhe të drejtave të njeriut</p> <ul style="list-style-type: none"> - Kushtetuta e Kosovës (neni 53 dhe 55) - Konventa Evropiane për të Drejtat e Njeriut <ul style="list-style-type: none"> o Kufizimi i përcaktuar me ligj o Qëllimi legjitim o Proporcionaliteti o Margjina e vlerësimit
Java e dhjetë:	<p>Rikthimi në Gjendje të Mëparshme</p> <ul style="list-style-type: none"> - Ligji për Gjykatën Kushtetuese (neni 50) - Rast studimi
Java e njëmbëdhjetë:	<p>Efekti horizontal</p> <ul style="list-style-type: none"> - Rasti Lüth (Vendim i Gjykatës Kushtetuese Gjermane, 1958).
Java e dymbëdhjetë:	<p>Detyrimet pozitive</p> <ul style="list-style-type: none"> - Neni 8 i Konventës Evropiane (Guerra v Italy (1998) 26 EHRR 357)
Java e trembëdhjetë:	<p>Doktrina e proporcionalitetit</p> <ul style="list-style-type: none"> - Hirst v UK (2005).
Java e katërbëdhjetë:	Kollokiumi 2

Politikat akademike dhe rregullat e mirësjelljes:

Cakto politikat e mirësjelljes konform statutit të UP-së.

- *Personeli akademik duhet të reflektojë një standard të lartë të integritetit personal e profesional gjatë veprimtarisë së punës, duke zbatuar kuadrin ligjor përkatës, për t'u siguruar që procesi i punës kryhet në mënyrë transparente dhe të përgjegjshme.*
- *mësimdhënësi duhet t'i njoftojë studentët lidhur me të drejtat dhe detyrimet e tyre gjatë vitit akademik dhe me kodin e mirësjelljes,*
- *të bëhet realizimi i papenguar i ligjëratave në atë mënyrë që të respektohet orari i ligjëratave,*
- *Kopjimi gjatë provimit dhe çdo lloj plagjiati janë rreptësishtë të ndaluara.*